



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

SHPALLJE

Aktiviteti për Bashkëpunim në Komunitet (CCA) – 2020

Promovimi i llogaridhënies së qeverisjes lokale dhe krijimi i një kohezioni më të madh social në nivel komunitetesh në komunat e Kosovës

Kërkesë për Aplikim

Rundi I

Data e shpalljes: 22 shtator, 2020

Data e mbylljes: 21 tetor, 2020

Ora e mbylljes: 17:00

Të nderuar aplikues,

Aktiviteti për Bashkëpunim në Komunitet (CCA) fton aplikues për grante që kontribuojnë në përmbushjen e dy objektivave si më poshtë:

- (1) *Rritjen e përfshirjes së qytetarëve në identifikimin dhe adresimin e sfidave të komunitetit lokal të grupeve të nënpërfaqësuar veçanërisht: gratë, të rinjtë dhe komunitetet joshumicë; dhe*
- (2) *Përmirësimin e bashkëpunimit multi-etnik për çështje që lidhen me komunitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve të grupeve të ndryshme etnike dhe qeverive të tyre lokale.*

Aplikacionet gjithashtu duhet të kontribuojnë kundrejt këtyre **katër rezultateve**:

Rezultati 1: Përfshirje më e madhe qytetare në identifikimin dhe zgjidhjen e sfidave të komunitetit lokal (me fokus të veçantë te gratë, të rinjtë dhe qytetarë tjerë të papërfaqësuar);

Rezultati 2: Përmirësim i bashkëpunimit multi-etnik rreth çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet në Kosovë;

Rezultati 3: Bashkëpunim më i mirë ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes komunale;

Rezultati 4: Rritje e kënaqshmërisë qytetare me performancën e komunave të tyre.

CCA planifikon të hapë dy runde të aplikimeve për grante. Gjatë këtij **rundi të parë**, CCA do të ndajë deri në pesë (5) grante me vlerë minimale prej \$5,000 dhe maksimale prej \$15,000, bazuar në fushën e aplikimeve. Grantet mund të implementohen në gjithë Kosovën, ndërsa inkurajohen iniciativat ndërkomunale.

USAID rezervon të drejtën për mos të financuar asnjë nga aplikantët.

Pakoja e aplikimit (përfshi KPA, formularin për aplikim dhe formularin për buxhet) mund të shkarkohet nga ueb faja e D+ tek: <https://dplus.org/grantet/>

Në përputhje me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, katër sesione informuese do të mbahen në mënyrë virtuale në platformën Zoom. Vegëza për t'ju bashkangjitur takimeve do të vendoset në faqen kryesore të ueb faqes së D+, një ditë para secilit sesion të planifikuar. Dy sesione do të mbahen në gjuhën shqipe dhe dy sesione në gjuhën serbe. Orari i mbajtjes së sesioneve informuese është si në vijim:

Në shqip:

1. 29.09.2020, ora 10:30

2. 06.10.2020, ora 10:30

Në serbisht:

1. 01.10.2020, ora 10:30

2. 07.10.2020, ora 10:30

Sesionet informuese do të ofrojnë të dhëna më të hollësishme mbi qëllimin e aktivitetit dhe procedurat për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacioneve. Përveç sesioneve informuese, subjektet e interesuara do të kenë mundësi të parashirojnë pyetje të tjera shtesë edhe përmes emailit: grants@dplus.org.

Afati i fundit për dërgim të pyetjeve është 8 tetor, 2020, në orën 17:00. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të vendosen në ueb faqen e D+ (<https://dplus.org/grantet/>), me datën 12 tetor, 2020 në orën 17:00 hrs.

Afati për aplikim:

Afati i fundit për ta dorëzuar aplikacionin është **21 tetor 2020, ora 17:00.**

Aplikacionet duhet të dërgohen vetëm **në mënyrë elektronike** në email adresën: grants@dplus.org

Aplikacionet e vonuara:

Aplikacionet e dorëzuar vonë apo të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë procesit të shqyrtimit.